

Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete

Sektori për Monitorimin e Sistemit Ligjor

Procedurat gjyqësore që përfshijnë dhunën në familje

Raport mujor

nëntor 2009

Procedurat gjyqësore që përfshijnë dhunën në familje

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) është e brengosur se dështimet për t'u marrë me rastet e dhunës në familje mund ta shkelin ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Shumë traktate dhe instrumente ndërkombëtare e kanë adresuar në mënyrë të drejtpërdrejt çështjen e dhunës në familje. Duke e njohur faktin që shumica e viktimave të dhunës në familje në tërë botën janë gra dhe fëmijë, si Konventa për eliminimin e diskriminimit ndaj gruas (KEDNG), ashtu edhe Konventa për të drejtat e fëmijëve (KDF) e kanë nënvizuar rolin që autoritetet duhet ta luajnë për t'i mbrojtur individët e cenueshëm nga dhuna dhe keqtrajtimi në sferën private.¹ Dhuna ndaj gruas është veçanërisht tinëzake pasi që, siç e ka cekur Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, “të gjitha format e dhunës ndaj gruas ndodhin në kontekst *de jure* dhe *de facto* të diskriminimit ndaj gruas dhe statusit më të ulët që i jepet gruas në shoqëri, duke u përkeqësuar edhe më tej përmes pengesave me të cilat gruaja përballet shpesh herë kur kërkon zgjidhje të situatës së saj nga shteti.”²

Dhuna në familje dhe procedurat gjyqësore në lidhje me dhunën në familje mund ta implikojnë gjithashtu edhe një numër të të drejtave të garantuara me Konventën evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ).³ Më mesin e tyre janë e drejta për jetën (neni 2), e drejta për të qenë i lirë nga çfarëdo trajtimi apo dënimi çnjerëzor apo degradues (neni 3), e drejta për një proces të rregullt (neni 6), e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8) dhe e drejta për të qenë i lirë nga diskriminimi (neni 14). Neni 1 i KEDNJ-së kërkon nga autoritetet që këto të drejta t'ia garantojnë çdo personi nën juridiksionin e tyre. Obligimet pozitive të autoriteteve, në disa raste sipas nenit 2 ose 3 kurse në rastet tjera sipas nenit 8 si të vetëm ose në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së, mund të përfshijnë, në rrethana të caktuara, edhe detyrën për ta mirëmbajtur dhe për ta zbatuar në praktikë një kornizë adekuate ligjore që ofron mbrojtje ndaj akteve të dhunës të kryera nga personat privatë.⁴

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje (në tekstin e mëtejshëm, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12) e themelon një procedurë civile sipas së cilës viktimat e pohuar e dhunës në familje mund të paraqesë kërkesë

¹ KEDNG nxit shtetet “të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë një politikë për eliminimin e dhunës ndaj gruas” dhe “të ushtrojnë vëmendjen e duhur për t'i parandaluar, hetuar dhe, në pajtim me legjislacionin e vendit, t'i dënojnë aktet e dhunës ndaj gruas, qofshin ato të kryera nga ana e Shtetit apo personat privatë.” Shih nenin 24(t)(i) dhe (iii) të Rekomandimit të përgjithshëm 19 të Komitetit për eliminimin e diskriminimit ndaj gruas. KEDNG-në e miratoi Asambleja e përgjithshme e KB-ve me Rezolutën 34/180, të datës 18 dhjetor 1979. KDF-ja kërkon nga autoritetet që t'i marrin “të gjitha masat e përshtatshme për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerjes ose keqtrajtim, braktisjes apo mospërfilljes, nëpërkëmbjes ose shfrytëzimit, duke përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.” KDF-në e miratoi Asambleja e përgjithshme e KB-ve me Rezolutën 44/25, të datës 20 nëntor 1989, dhe hyri në fuqi më 2 shtator 1990.

² Paragrafi 8 i Rezolutës 2003/45 të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, që e ka cituar Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut (GjEDNJ) në paragrafin 188 të aktgjykimit në lëndën *Opuz kundër Turqisë*, të datës 9 qershor 2009.

³ Konventa evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ) dhe e drejta përkatëse lëndore e GjEDNJ-së janë të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë, shih nenin 1.3(b) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 mbi ligjin e zbatueshëm në Kosovë; shih nenin 3.2(b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 mbi Kornizën kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme; nenin 22(2) dhe 53 të Kushtetutës. Këshilli i Evropës e miratoi KEDNJ-në më 5 nëntor 1950, në Romë..

⁴ Paragrafi 65 i aktgjykimit të GjEDNJ-së në lëndën *Bevacqua dhe S. kundër Bullgarisë*, të datës 12 qershor 2008. Autoritetet kanë obligim pozitiv për t'i marrë masat adekuate për të garantuar që individët të mos i nënshtrohen trajtimit çnjerëzor ose degradues, duke përfshirë rastet kur një keqtrajtimi i tillë vjen nga personat privatë. Paragrafi 22 i aktgjykimit të GjEDNJ në lëndën *A. kundër Britanisë së Madhe*, të datës 23 shtator 1998; paragrafi 73 i aktgjykimit të GjEDNJ në lëndën *Z. kundër Britanisë së Madhe*, të datës 10 maj 2001; paragrafët 148-166 të aktgjykimit të GjEDNJ në lëndën *M.C. kundër Bullgarisë*, të datës 4 dhjetor 2003.

për një urdhër për mbrojtje, urdhër për mbrojtje emergjente, apo urdhër për mbrojtje të përkohshme emergjente.⁵ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12 e përmban një listë shteruese të akteve dhe lëshimeve që mund të përbëjnë dhunë në familje nëse kryhen ndaj një personi me të cilin kryerësi është apo ka qenë në lidhje familjare.⁶ Nëse gjykata gjen që kërkesa e pranuar është e bazuar, ajo mund të nxjerrë një urdhër për mbrojtje apo urdhër për mbrojtje emergjente. Kërkesat për urdhra për mbrojtje të përkohshme emergjente duhet të paraqiten te organet e zbatimit të ligjit jashtë orarit të punës së gjykatave dhe, nëse aprovohen, skadojnë në fund të ditës së ardhshme gjatë së cilës punon gjykata.⁷ Neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr 2003/12 i rendit masat që mund të shqiptohen me anë të tri llojeve të urdhrave.

Pavarësisht se a ekziston apo jo ndonjë procedurë penale kundër të pandehurit, ajo nuk duhet të paragjykojë vendimin për lëshimin e urdhrit për mbrojtje.⁸ Dhuna në familje nuk është vepër e veçantë penale *si i tillë*,⁹ mirëpo shkelja e urdhrit të nxjerrë sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12 është vepër penale.¹⁰ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12 kërkon ndjekje automatike të shkeljes së urdhrit për mbrojtje, urdhrit për mbrojtje të përkohshme ose urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente.¹¹ Shkelja e tillë, qoftë e plotë apo e pjesshme, dënohet me gjobë prej 200 euro deri në 2000 euro, ose me burgim deri në gjashtë muaj.¹² Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12 gjithashtu kërkon ndjekje automatike të veprës penale të lëndimit të lehtë trupor dhe/ose dëmtimin e pasurisë së tjetrit në kontekstin e dhunës në familje.¹³

Prej publikimit të *Raportit të OSBE-së për rastet e dhunës në familje në Kosovë*, në korrik të vitit 2007, OSBE-ja ka vazhduar t'i monitorojë lëndët e dhunës në familje në gjykatat e Kosovës.¹⁴ Problemet kryesore që OSBE-ja i ka vërejtur gjatë këtij monitorimi përfshijnë vonesat e kundërligjshme për të caktuar seanca ose për të vendosur mbi kërkesat për urdhër për mbrojtje apo urdhër për mbrojtje emergjente, dështimi për t'i përfshirë përfaqësuesit e qendrave për punë sociale në procedurat civile për dhunën në familje, zbatimi i gabueshëm i ligjeve përkatëse nga ana e gjykatave dhe dështimi për t'i ndjekur veprat penale të dhunës në familje.

A. Vonesat

⁵ E shpallur më 9 maj 2003.

⁶ "Lidhja familjare" do të thotë lidhja ndërmjet dy personave: (a) të cilët janë të fejuar apo të martuar me njëri tjetrin apo bashkëjetojnë me njëri tjetrin pa qenë të martuar; (b) të cilët përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesore ose birësimi apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët nipat, vëllezërit e motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët, ose kushërinjtë; ose (c) të cilët janë prindër të një fëmije të përbashkët. Neni 1.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr 2003/12.

⁷ Shih nenin 13 të Rregullores së UNMIK-ut nr 2003/12.

⁸ Neni 8.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr 2003/12.

⁹ Kodi penal i Kosovës (Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/26, të datës 6 korrik 2003, me gjithë ndryshimet e mëvonshme; në tekstin e mëtejshëm, KPK) nuk e inkriminon "dhunën në familje" si të tillë me ndonjë nen specifik, por në fakt parasheh rritje të dënimit, apo klauzola rënduese, për vepra të veçanta penale kur ato ndodhin në kontekst të "marrëdhënies familjare." Shih, për shembull, veprën penale lëndimi i lehtë trupor (neni 153(4) KPP); lëndimi i rëndë trupor (neni 154(3) KPP); shtrëngimi (neni 160(2) KPP); kanosja (neni 161(3) KPP); privimi i kundërligjshëm i lirisë (neni 162(4) KPP); dhunimi (neni 193(7,8) KPP); sulmi seksual (neni 195(2)7,8 KPP) dhe të tjera.

¹⁰ Neni 15 i Rregullores së UNMIK-ut nr 2003/12.

¹¹ Neni 16.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr 2003/12.

¹² Neni 15 i Neni 15 i Rregullores së UNMIK-ut nr 2003/12.

¹³ Neni 16.2 dhe 16.3 Neni 15 i Rregullores së UNMIK-ut nr 2003/12.

¹⁴ Raporti vëren që fushat kryesore problematike në lidhje me procedurën civile për dhunën në familje përfshijnë: vonesat e kundërligjshme për t'i caktuar seancat dhe për të vendosur mbi kërkesat për urdhra për mbrojtje; mungesa e përfaqësuesve të qendrave për punë sociale në seanca ku viktimat apo dëshmitarët ishin fëmijë, dhe arsyetimi i pamjaftueshëm i vendimeve në lidhje me dhunën në familje. Përveç kësaj, raporti gjithashtu thekson brengat rreth procedurës ankimore në rastet e dhunës në familje dhe dështimin e autoriteteve për t'i ndjekur sipas detyrës zyrtare veprat penale që janë kryer gjatë incidenteve të dhunës në familje. Raporti gjendet në: http://www.osce.org/documents/mik/2007/07/25771_en.pdf.

Zvarritjet e procedurës gjyqësore në lëndët e dhunës në familje mund ta rrezikojnë integritetin personal të viktimave dhe të çojnë drejt shkeljeve të ligjit ndërkombëtar dhe vendor. Sipas GjEDNj-së, drejtësia duhet të ndahet “pa vonesa që mund ta rrezikojnë efikasitetin dhe besueshmërinë e saj”.¹⁵ E drejta lëndore e themeluar prej kohësh e GjEDNj-së kërkon nga autoritetet që t’i organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në atë mënyrë që gjykatave t’u mundësohet të veprojnë në pajtim me standardet për të drejtat e njeriut.¹⁶

Përveç kësaj, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka theksuar që “është e nevojshme për palët që të kenë në dispozicion forma të thjeshtuara dhe më të shpejta të procedurës dhe të mbrohen nga taktikat keqtrajtuese apo zvarritëse.” Parimet e tij theksojnë që “procedura civile do të duhej të përbëhet nga jo më shumë se dy seanca, e para prej të cilave mund të jetë seancë preliminare e natyrës përgatitore, kurse e dyta të shërbejë për t’i marrë dëshmitë, për t’i dëgjuar argumentet dhe, aty ku kjo është e mundshme, për ta nxjerrë aktgjykimin.”¹⁷

Ligji vendor parasheh afate të qarta kohore brenda të cilave gjykata vendos mbi kërkesat për urdhër për mbrojtje dhe urdhër për mbrojtje emergjente. Për një urdhër për mbrojtje, gjykata duhet të vendosë brenda 15 ditëve, ndërsa afati i fundit për të vendosur për një urdhër për mbrojtje emergjente është 24 orë.¹⁸ Qëllimi i këtyre afateve të shkurta kohore është që kërkuesit të mbrohen nga rreziku i dëmtimit të mëtejshëm. Megjithatë, vonesat e kundërligjshme për të caktuar seancë apo për të vendosur mbi kërkesën për urdhër për mbrojtje dhe urdhër për mbrojtje emergjente vazhdojnë të jenë një shkelje serioze e vërejtur rregullisht në lëndët e dhunës në familje.¹⁹ Në vijim janë paraqitur dy shembuj të vonesave të kundërligjshme gjyqësore që i ka monitoruar OSBE-ja:

Më 8 janar 2009, në një gjykatë në rajonin e Prishtinës, një kërkuese paraqiti kërkesë për urdhër për mbrojtje kundër një numri të të paditurve për dhunën e pohuar psikologjike dhe mohimin e qasjes në shtëpinë ku ajo kishte jetuar për 25 vite. Më 11 nëntor 2009, u mbajt seanca e parë dhe u dëgjuan të dy palët. Megjithatë, gjykatësi vendosi që kushtet për ta vazhduar seancën nuk ishin plotësuar dhe e shtyu seancën. Në seancën e dytë të mbajtur më 4 mars 2009, pothuajse dy muaj pasi që ishte paraqitur kërkesa, gjykata më në fund nxjerri një vendim mbi kërkesën për urdhër për mbrojtje.

Më 14 shkurt 2008, në një gjykatë në rajonin e Prishtinës, një kërkuese paraqiti një kërkesë për urdhër për mbrojtje kundër bashkëshortit të saj dhe anëtarëve të familjes së ngushtë të tij, me të cilët ishin duke jetuar në shtëpinë e njëjtë. Kërkuesja kërkoi një urdhër për mbrojtje për shkak të detyrimit

¹⁵ Shih paragrafin 61 të aktgjykimit të GjEDNj-së në lëndën *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, të datës 27 tetor 1994, të ritheksuar në paragrafin 21 të aktgjykimit të GjEDNj-së në rastin *Ferrari kundër Italisë*, të datës 28 korrik 1999.

¹⁶ Shih paragrafin 29 të aktgjykimit të GjEDNj-së në lëndën *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës*, të datës 13 korrik 1983. Kur të përballen me ngarkesë të përkohshme me punë të pakryera, autoritetet publike duhet të ndërmarrin me një shpejtësi të kërkuar veprime të nevojshme për ta zgjidhur një situatë të veçantë të këtij lloji. Shih paragrafin 23 të të aktgjykimit të GjEDNj-së në lëndën *Baggetta kundër Italisë*, të datës 25 qershor 1987.

¹⁷ Neni 1 i Rekomandimit nr. R (84) 5 mbi parimet e procedurës civile të menduara për ta përmirësuar funksionimin e drejtësisë, i miratuar nga Komiteti i Ministrave në mbledhjen e 387 të Zëvendësministrave të Këshillit të Evropës.

¹⁸ Neni 7.1 dhe 9.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12.

¹⁹ Shih *Raportin për rastet e dhunës në familje në Kosovë* (korrik, 2007) të përmendur më lart, si dhe Raportet mujore të marsit të vitit 2005 dhe të gushtit të vitit 2005 të Departamentit të OSBE-së për të drejta të njeriut dhe sundim të ligjit (tani Departamenti për të drejta të njeriut dhe komunitete).

psikologjik dhe fizik. Më 24 prill 2008, nëntë javë më vonë, gjykata nxjerri një vendim me të cilin gjeti që kërkesa për urdhër për mbrojtje ishte e bazuar.

Në shembujt e mësipërm, përkundër afateve të fundit ligjore të përcaktuara qartë, vendimet mbi kërkesat për urdhër për mbrojtje ishin nxjerrë vetëm atëherë kur kishin kaluar gjashtë deri nëntë javë prej kur ishte paraqitur kërkesa.

Problemi i zvarritjeve të procedurës gjyqësore është veçanërisht akut në lidhje me kërkesat për urdhër për mbrojtje emergjente. OSBE-ja e ka vërejtur një numër të lëndëve në rajonin e Prizrenit ku, pas zvarritjeve të vazhdueshme për të vendosur mbi kërkesat për urdhër për mbrojtje emergjente, gjykatat kanë nxjerrë urdhër të zakonshëm për mbrojtje në vend të urdhrimit për mbrojtje emergjente. Zbatimi i gabueshëm i ligjit, i kombinuar me zvarritjen e kundërligjshme të procedurës, mund të rezultojë me dëmtim të mëtejshëm të viktimave të dhunës në familje. Në vijim janë paraqitur disa shembuj të shtyrjeve të vazhdueshme të seancave që rezultuan me shkelje të afatit ligjor dhe i rrezikuan të drejtat e të përfshirëve në procedurë:

Më 19 mars 2009, në një gjykatë në rajonin e Prizrenit, kërkuesi paraqiti kërkesë për urdhër për mbrojtje emergjente kundër të birit të tij për shkak të sjelljes së pohuar të keqe dhe kërcënimeve me sulm [fizik].²⁰ Seanca e parë nuk u caktua deri më 6 prill 2009. Seanca u shty deri më 15 prill dhe pastaj deri më 24 prill 2009, fillimisht për shkak të mungesës së gjykatësit, e më vonë për shkak të mungesës së të paditurit, i cili gjendej në paraburgim. Seanca kryesore u mbajt më në fund më 7 maj 2009, ku gjykata nxori një urdhër të zakonshëm për mbrojtje.

Më 30 mars 2009, në një gjykatë në rajonin e Prizrenit, një kërkuese e mitur dhe shtatzënë paraqiti kërkesë për urdhër për mbrojtje emergjente për shkak të dhunës së pohuar që po e vuante nga partneri i saj, me të cilin ishte duke bashkëjetuar pa qenë të martuar, dhe nga familja e tij. Seanca e parë u mbajt shtatë ditë pasi që ishte paraqitur kërkesa, ndërsa ajo u shty njëherë deri më 23 prill 2009, pastaj përsëri deri më 5 maj 2009. Seancat fillimisht u shtynë për shkak të mungesës së provës që dëshmonin se i padituri ishte ftuar në gjyq si duhet, kurse më vonë për shkak të deklaratës së të paditurit që kishte vështirësi për ta kuptuar kërkesën pasi që ajo nuk ishte e shkruar në gjuhën e tij amtare, përkatësisht në gjuhën boshnjake. Seanca e tretë dhe e fundit u mbajt më 5 maj 2009, kur një gjykatës e kuptoi që kërkesa ishte për urdhër për mbrojtje emergjente. Atëherë, ai e pyeti palën e mbrojtur nëse dëshironte urdhër të zakonshëm për mbrojtje apo urdhër për mbrojtje emergjente. Pala e mbrojtur u përgjigj që më nuk dëshironte urdhër për mbrojtje emergjente, por vetëm urdhër të zakonshëm për mbrojtje. Të njëjtën ditë, 35 ditë pasi që ishte paraqitur kërkesa për urdhër për mbrojtje emergjente, gjykata nxjerri një vendim me të cilin e lejoi urdhrin e zakonshëm për mbrojtje.

Dështimet e mësipërme të gjykatave për të vendosur mbi kërkesat, brenda afatit të parashkruar ligjor, e vënë në rrezik integritetin trupor të viktimës dhe e zhvlerësojnë natyrën e urdhrimit për mbrojtje emergjente. Urdhri për mbrojtje emergjente është për

²⁰ Pala e mbrojtur kërkoi nga gjykata që t'i nxjerrë urdhrat e përshkruar në nenin 2(1) (a) - (d) dhe (f) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12.

t'u përdorur si përgjigje ndaj një kërcënimi të afërt dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e palës së mbrojtur.

B. Dështimi për t'i përfshirë përfaqësuesit e qendrave për punë sociale në procedurën civile për dhunë në familje

Përveç vonesave të mëdha për të caktuar seanca dhe për të vendosur mbi kërkesat për urdhra për mbrojtje, OSBE-ja ka vërejtur edhe dështime të gjykatave për t'i dëgjuar mendimet e përfaqësuesve të qendrave për punë sociale (QPS) në rastet që kanë të bëjnë me të miturit. Ndonëse sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12, roli i një përfaqësuesi të QPS-së është vetëm që të dëgjohet si dëshmitar,²¹ neni 80 i Ligjit për Procedurën kontestimore parasheh përfaqësimin ligjor për një person që është i moshës nën 18 vjeç.²² Për më tepër, KDF-ja përcakton që në procedurat gjyqësore, në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, interesat e fëmijës duhet të jenë konsiderata primare.²³ Gjykata ka përgjegjësi që aty ku është e nevojshme ta përfshijë QPS-në në rastet që kanë të bëjnë me të miturit.

OSBE-ja ka monitoruar lëndët e dhunës në familje ku kanë qenë të përfshirë të miturit dhe ku gjykata nuk e kishte thirrur apo nuk e kishte dëgjuar QPS-në. Për shembull:

Në rastin e theksuar më lart, parashtruesja e mitur dhe shtatzënë e kërkesës, parashtrroi kërkesë për urdhër për mbrojtje emergjente për shkak të dhunës që po e vuante nga partneri i saj, me të cilin ishte duke bashkëjetuar pa qenë të martuar, dhe nga familja e tij. Gjatë procedurës, gjykata asnjëherë nuk e thirri përfaqësuesin e QPS-së.

Më 24 shkurt 2009, në një gjykatë në rajonin e Prishtinës, një parashtruese e kërkesës paraqiti kërkesë për urdhër për mbrojtje kundër bashkëshortit të saj për shkak të dhunës nga e cila po vuante ajo dhe pesë fëmijët e tyre (tre prej të cilëve ishin të mitur). Përmes kërkesës, ajo kërkoi nga gjykata që ta nxjerrë një urdhër për mbrojtje për ta parandaluar të paditurin që të kryejë akte të dhunës në familje ndaj saj dhe fëmijëve të tyre dhe për ta detyruar të paditurin që ta kthejë djalin e tyre në banim me familjen e kërkueses për shkak të rrezikut për sigurinë e tij fizike dhe mentale që po kanosej nga jeta e përbashkët me të paditurin. Sipas aktgjykimit, kërkesa për urdhër për mbrojtje ishte e bazuar. Megjithatë, QPS-ja nuk u përfshi fare gjatë procedurës.

Në të dy lëndët, një përfaqësues nga QPS-ja do të duhej të ishte i pranishëm për t'i përfaqësuar interesat më të mirë të të miturve të përfshirë, apo për të dëshmuar në lidhje me to.

C. Zbatimi i gabueshëm i ligjit nga ana e gjykatave

²¹ Neni 7.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12.

²² Shih nenin 182.2(k) të Ligjit nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore.

²³ Neni 3.1 i KDF-së.

OSBE-ja ka vërejtur që gjykatat në Kosovës shpesh herë e zbatojnë gabimisht Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/12 gjatë punës me kërkesat për urdhër për mbrojtje ose kërkesat për urdhër për mbrojtje emergjente. Si pasojë, gjykatat nganjëherë zhvillojnë procedura dhe nxjerrin aktgjykime që shkelin si ligjin vendor, ashtu edhe atë ndërkombëtar. Në veçanti, OSBE-ja ka monitoruar lëndë në të cilat gjykata: 1) nuk i ka trajtuar urdhrat për mbrojtje emergjente ndryshe nga urdhrat e zakonshëm për mbrojtje, si gjatë procedurës, ashtu edhe me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit; 2) nuk ka nxjerrë aktgjykime në pajtim me kërkesat formale të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12; dhe 3) ka nxjerrë urdhra për mbrojtje që kanë ndikuar negativisht në të drejtat e individëve që nuk janë përmendur si të paditur në ato lëndë.

1. Dështimi i gjykatave për t'i trajtuar urdhrat për mbrojtje emergjente ndryshe nga urdhrat e zakonshëm për mbrojtje

OSBE-ja ka vërejtur që gjykatat i trajtojnë shpesh herë kërkesat për urdhra për mbrojtje dhe urdhra për mbrojtje emergjente në mënyrë të njëjtë, si dhe dështojnë shpesh herë që t'i njohin dallimet ligjore mes këtyre dy llojeve të kërkesave. Siç është përmendur më lart në lidhje me vonesat gjyqësore, një nga dallimet kryesore mes urdhrave për mbrojtje dhe urdhrave për mbrojtje emergjente është afati i paraparë me ligj brenda të cilit gjykatat duhet të vendosin mbi kërkesat përkatëse. Duke mos vendosur mbi kërkesat për urdhër për mbrojtje emergjente në një mënyrë veçanërisht të shpejtë, gjykatat mund ta shkelin të drejtën e kërkuesve për një kornizë adekuate ligjore që ofron mbrojtje nga aktet e dhunës të kryera nga personat privatë.²⁴

Me rastin e parashtrimit të kërkesës për urdhër për mbrojtje emergjente, gjykata duhet gjithashtu të përcaktojë nëse e paditura paraqet “kërcënim të menjëhershëm apo të pashmangshëm për sigurinë, shëndetin apo mirëqenien e palës së mbrojtur apo atij që do të mbrohet me urdhrin për mbrojtje.”²⁵ Përveç dështimit të marrjes së vendimeve për kërkesat për mbrojtje emergjente brenda afatit të kërkuar kohor që është 24 orë,²⁶ OSBE-ja ka vërejtur që kur këto kërkesa për urdhër-mbrojtje emergjente iu paraqiten gjykatave, ato shpesh nuk e përcaktojnë në mënyrë adekuate nëse ekziston kërcënimi i menjëhershëm dhe i pashmangshëm. Në vend të marrjes së vendimit për kërkesat për mbrojtje emergjente duke vlerësuar shpejtë nëse kushtet e paraparë në Rregulloren e UNMIK-ut 2003/12 neni 10.1 (a)-(c) ekzistojnë, gjykatat marrin vendim pa i vlerësuar këto kritere. Në disa raste të monitoruara, gjykatat janë lëshuar në procedura tjera të panevojshme para apo në lidhje me përcaktimin e ekzistimit të bazave të kërkuara për lëshimin e urdhrat për mbrojtje emergjente.

Rastet në vijim shërbejnë si shembuj:

²⁴ Sipas të drejtës lëndore të GjEDNj-së: “[...] obligimet pozitive të autoriteteve – në disa raste sipas neneve 2 dhe 3, kurse në rastet tjera sipas nenit 8 si të vetëm apo në lidhje me nenin 3 të Konventës – mund të përfshijnë, në rrethana të caktuara, edhe detyrën për ta ruajtur dhe zbatuar në praktikë një kornizë adekuate ligjore që ofron mbrojtje nga aktet e dhunës të kryera nga personat privatë.” Shih paragrafët 64-65 të aktgjykimit të GjEDNj-së në lëndën *Bevacqua dhe S. kundër Bullgarisë*, të datës 12 qershor 2008. Për më tepër, autoritetet duhet t'i ndërmarrin hapat përkatës për ta ruajtur jetën e personave nën juridiksionin e tyre. Shih paragrafin 36 të aktgjykimit në lëndën *L.C.B. kundër Britanisë së Madhe, të datës 9 qershor 1998, Raporte të aktgjykimeve dhe vendimeve 1998-III*. Shih gjithashtu paragrafët 115-116 të aktgjykimit të GjEDNj-së në lëndën *Osman kundër Britanisë së Madhe*, të datës 28 tetor 1998.

²⁵ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 neni 10.1(b). Për të lëshuar një urdhër për mbrojtje emergjente, gjykata duhet gjithashtu të gjejë nëse ekzistojnë të njëjtat baza si ato që kërkohen për lëshimin e urdhrat të rregullt për mbrojtje (që ekziston bazë për të besuar që pala përgjegjëse ka kryer apo ka kërcënuar se do ta kryej ndonjë akt të dhunës në familje, dhe që lëshimi i urdhrat për mbrojtje emergjente është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, dhe mirëqenien e palës së mbrojtur apo personit që ka marrëdhënie familjare me palën e mbrojtur dhe i/e cili/a duhet të mbrohet me urdhër për mbrojtje). Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 10.1 (a) dhe (c) (njëjtë sikur Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 neni 8.1 (a) dhe (b)).

²⁶ Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2003/12 nenin 9.1.

Në një rast të ngritur pranë një gjykate në rajonin e Prizrenit, kërkuesi kërkonte urdhër për mbrojtje emergjente. Mirëpo në vend të vlerësimit nëse ekzistonte kërcënimi i menjëhershëm dhe i pashmangshëm, gjykata kishte dështuar në vlerësimin e këtij kriteri. Në vend të kësaj gjykata lëshoi urdhër të zakonshëm për mbrojtje të kërkuesit.

Në një rast të ngritur pranë një gjykate në rajonin e Mitrovicës, pas kërkesës së parashtruar nga prokurori publik me 27 shkurt 2009, parashtruesi i kërkesës kërkonte urdhër për mbrojtje emergjente. Në shqyrtimin kryesor të mbajtur më 18 mars 2009, përfaqësuesi i QPS-së paraqiti tri deklaratatë të nënshkruara nga viktima dhe pala përgjegjëse, në të cilat thuhej se palët janë pajtuar dhe “i kanë premtuar njëra tjetrës që nuk do t’i përsërisin veprat e tyre të dhunshme në të ardhmen.” Deklaratatë të nënshkruara gjithashtu tregonte se viktima është pajtuar që prapë të jetojë me palën përgjegjëse. Viktima nuk ishte e pranishme në gjykatë. Mirëpo, në shqyrtimin kryesor, prokurori publik i Mitrovicës dhe ndihmësi i viktimit të dy e mbështetën kërkesën për urdhër për mbrojtje emergjente. Pavarësisht nga procedura e pajtimit, më 18 mars 2009 gjykata mori vendim për ta lejuar palën e mbrojtur që ta përdorë të njëjtën shtëpi ku banonte edhe pala përgjegjëse, apo një pjesë të saj. Derisa vendimi thoshte që ishte nxjerr në bazë të nenit 8.1 (b) dhe 8.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/12, termet si “urdhër për mbrojtje” dhe “urdhër për mbrojtje emergjente” janë përdorur si shkëmbim për njëra tjetrën pothuajse në tërë vendimin. Ndonëse vendimi nuk e ka caktuar seancën për konfirmim, përdorimi sporadik i termit “urdhër për mbrojtje emergjente” në tekst e ka bërë të paqartë si bazën ashtu edhe qëllimin e vendimit.

Ndonëse në rastin e përmendur më lart është e paqartë se kush e ka iniciuar procedurën e pajtimit, OSBE-ja gjithashtu ka monitoruar raste në të cilat gjykatat nuk e kanë respektuar natyrën urgjente të kërkesave duke vonuar vendimet e tyre lidhur me këto kërkesa në mënyrë që të merren me procedurat e pajtimit në mënyrë proaktive.

Në një rast të ngritur pranë një gjykate në rajonin e Prizrenit më 23 mars 2009, në vend të përpjekjeve për përcaktimin nëse kërkesa për urdhër për mbrojtje emergjente është e bazuar, gjyqtari e përdori seancën si forum për të bërë përpjekje për pajtimin e palëve. Ndonëse palët më në fund ishin pajtuar, ndërprerja nga ana e gjykatës e këtyre procedurave ishte e gabuar, meqë kërkesa ishte për urdhër për mbrojtje emergjente dhe gjyqtari është dashur që menjëherë të vlerësojë dëshmitë për të parë nëse ka nevojë për lëshimin e një urdhri të tillë duke marrë vendim në kërkesën edhe pastaj nëse është me vend, të merret me idenë e pajtimit. Përveç vonësës së panevojshme të procedurave, këto përpjekje kanë mundur ta vënë në rrezik shëndetin dhe sigurinë e kërkuesit.

Përveç shkeljes së kërkesave të rregullores së UNMIK-ut 2003/12 që kërkesat për urdhra për mbrojtje emergjente të vendoset brenda periudhës 24 orëshe, një iniciim i tillë i procedurave të pajtimit gjithashtu mund të bie në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut më herët ka konstatuar që ndjekja e procedurave të ngadalshme nga gjykata, së bashku me dështimin për të

ndërmarrë veprime të mjaftueshme si reagim ndaj sjelljes së dhunshme, mund të shpie në shkelje të së drejtës për respektim të jetës private dhe familjare.²⁷

Në rastin e monitoruar në vijim, gjykata është lëshuar në shqyrtimin e kërkesës për ekzekutim të urdhrat për mbrojtje emergjente ndonëse urdhrat për mbrojtje janë të vetëekzekutueshme.

Më 26 janar 2009, një gjykatë në rajonin e Prishtinës ka lëshuar një aktgjykim që konstatonte se kërkesa e parashtruesit për urdhër për mbrojtje emergjente ishte e bazuar. Aktgjykimi ndër masa tjera i garantonte palës së mbrojtur përdorimin e shtëpisë ku ajo jetonte së bashku me të paditurin dhe dy fëmijët e tyre. Më 23 shkurt 2009, meqë kushtet e aktgjykimit me sa duket nuk janë respektuar nga i padituri, pala e mbrojtur kishte paraqitur kërkesë për ekzekutimin e urdhrat për mbrojtje emergjente. Gjykata më në fund kishte ekzekutuar vendimin për mbrojtje emergjente më 4 maj 2009, duke e vendosur të paditurin në shtëpi në bazë të kushteve të urdhrat për mbrojtje emergjente.

E tëra kjo procedurë e përmendur më lart është e paraparë në Rregulloren e UNMIK-ut 2003/12. Kur një urdhër për mbrojtje emergjente të jetë lëshuar një herë, ajo mbetet në fuqi deri në seancën e konfirmimit, që duhet të caktohet brenda 20 ditëve të lëshimit të urdhrat.²⁸ Në rastin e cekur më lart kërkuesit iu është dashur të presë përmbi tre muaj për zbatimin e urdhrat për mbrojtje emergjente, urdhër ky që duhet të hyjë në fuqi menjëherë pas lëshimit nga gjykata dhe zbatohet kundër të paditurit me dorëzimin e tij personalisht të paditurit në përputhje me Ligjin mbi Procedurën Kontestimore.²⁹

2. Dështimi i gjykatave në nxjerrjen e aktgjykimeve sipas kërkesave formale të Rregullores së UNMIK-ut 2003/12

OSBE-ja ka përmendur disa raste në të cilat aktgjykimet e gjykatave kanë nxjerrë aktgjykime që nuk kanë qenë në përputhje me kërkesat formale të Rregullores së UNMIK-ut 2003/12 për vendimet lidhur me kërkesat për urdhra mbrojtës dhe urdhra për mbrojtje emergjente. Dështimi për të vepruar në përputhje me këto kërkesa rrezikon si aftësinë e parashtruesve të kërkesës, ashtu dhe atë të të paditurve për të mësuar dhe avokuar për zbatimin e të drejtave të tyre ligjore.

a. Dështimi për caktimin e afatit kohor të urdhrat për mbrojtje

Në shumë raste të monitoruara nga OSBE-ja, Gjykatat nuk e kanë caktuar afatin kohor të urdhrave për mbrojtje.³⁰ Rasti në vijim është një shembull i kësaj:

²⁷ Neni 8, KEDNJ. Shih paragrafët 64-76 të Aktgjykimit të GjEDNJ *Bevacqua dhe S. kundër Bullgarisë*, të datës 12 qershor 2008. Në këtë rast, GjEDNJ ka gjetur që lehtësimi i pajtimit ka qenë i paarsyeshëm për shkak të rrethanave konkrete që kanë kërkuar përshpejtim të procedurave.

²⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12, neni 10.3(d).

²⁹ Shih Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12, neni 10.4 dhe 10.6.

³⁰ Neni 8.3(a) i Rregullores së UNMIK-ut 2003/12 kërkon që urdhrat për mbrojtje të përmbajë kohëzgjatjen e urdhrat për mbrojtje që nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj. Neni 10.3 (b) i rregullores kërkon që urdhri për mbrojtje emergjente të përmbajë kohëzgjatjen e urdhrat, që skadon me përfundimin e dëgjimit për vërtetimin e urdhrat për mbrojtje emergjente. Sa i përket neni 10.3 (d), data e dëgjimit për vërtetimin e urdhrat për mbrojtje emergjente duhet të jetë brenda njëzetë (20) ditëve prej lëshimit të urdhrat për mbrojtje emergjente.

Më 18 mars 2009, një gjykatë në rajonin e Mitrovicës ka lëshuar një urdhër për mbrojtje në përputhje me kërkesën e parashtrueses së kërkesës e cila kishte thënë që i padituri, i cili ishte bashkëshorti i saj, e kishte kërcënuar dhe rrahur atë. Mirëpo, në vend të caktimit të kohëzgjatjes së urdhrit për mbrojtje, gjykata vetëm përsëriti formulimin e përdorur në Rregulloren e UNMIK-ut 2003/12, neni 8.3(b), duke thënë që “kohëzgjatja e urdhrit për mbrojtje nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj.”

Një gjuhë e tillë e dykuptimtë mund të paragjykojë në mënyrë negative të drejtat e kërkueses si dhe të paditurit nëse më vonë ndonjëri nga ta dëshiron të ndërmarrë veprime tjera lidhur me urdhrin për mbrojtje.

Derisa disa gjykata e kanë lënë afatin kohor të urdhrave për mbrojtje të paqartë thjeshtë duke cituar formulimin e Rregullores së UNMIK-ut 2003/12, të tjerët fare nuk e kanë përmendur kohëzgjatjen e urdhrit për mbrojtje.

Më 12 Mars 2009, një gjykatë në rajonin e Mitrovicës ka lëshuar një urdhër për mbrojtje kundër të paditurit. Urdhri nuk përmbante as arsyetimin e as kohëzgjatjen e masave të urdhëruara për mbrojtje.

b. Gjykatat kërkojnë nga kërkuesit të paguajnë shpenzime të tepërta

Neni 6.5 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/12 i liron parashtruesit e kërkesave të lëndëve të dhunës në familje nga pagesa e taksave gjyqësore. Mirëpo, OSBE-ja ka monitoruar disa raste ku gjykatat nuk e kanë përfillur këtë lirim dhe kanë kërkuar nga parashtruesi i kërkesës për urdhër për mbrojtje apo për urdhër për mbrojtje emergjente që të paguajnë së paku një pjesë të shpenzimeve të gjykatës që kishin të bënin me procedurat.

Në urdhrat për mbrojtje të lëshuara në emër të dy kërkuesve të ndryshëm dhe kundër dy të paditurve të ndryshëm më 18 mars 2009 nga një gjykatë në rajonin e Mitrovicës, gjyqtari i urdhëroi palët që vetë t'i paguajnë shpenzimet.

c. E drejta për t'u ankuar nuk është përmendur në aktgjykime

Neni 11 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/12 parasheh që ankesa kundër vendimit ndaj kërkesës për mbrojtje emergjente apo vendimit për vërtetimin e urdhrit për mbrojtje emergjente parashtrohet brenda tetë ditëve nga lëshimi i urdhrit të tillë. Neni 8.3 i Rregullores më tutje kërkon që vetë urdhri për mbrojtje të përmbajë njoftimin lidhur me të drejtën për t'u ankuar brenda tetë ditëve nga pranimi i një urdhri të tillë. Mirëpo, urdhrat mbrojtës të lëshuar nga gjykatat e Kosovës shpesh dështojnë që në mënyrë adekuate t'i informojnë të paditurit për të drejtën e tyre për t'u ankuar.

Shumë gjykata i kanë njoftuar palët në një pjesë të Aktgjykimit të shkruar që ankesa kundër urdhrave mbrojtës nuk e ndalon ekzekutimin e tij. Mirëpo shumë nga to nuk e kanë përmendur afatin e fundit për ankesë. Për më tepër në disa nga aktgjykimet e

nxjerra nga disa gjykata në rajonin e Prizrenit, Pejës dhe Mitrovicës, OSBE-ja ka vërejtur dështimi për të përmendur mundësinë e ankesës në çfarëdo mënyre.

d. Ekzistimi i arsytimit të dobët ose mosekzistimi i arsytimit në aktgjykime

Siç është përmendur në disa raste, OSBE-ja prapë ka identifikuar arsytim të pamjaftueshëm në vendimet për urdhrat për mbrojtje në shumë raste të monitoruara. Një vendim i arsytuar kërkohet si nga e drejta vendore ashtu edhe ajo ndërkombëtare. Sipas së Ligjit të aplikueshëm për Procedurën Kontestimore (LPK),³¹ shkelja e këtij ligji ekziston gjithnjë kur vendimi përmban defekte të caktuara që përfshinë: a) nëse dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm apo në kundërshtim me arsytimin e vendimit; b) nëse vendimi nuk përmban fare arsytim, përmban arsytim të paqartë, apo nuk jep arsytim për faktet përfundimtare; c) nëse ekzistojnë kundërthënie ndërmjet deklaratës përfundimtare për faktet dhe vendimit, dokumentit kryesor, procesverbaleve procedurale, apo procesverbal nga seancat.³²

Gjykata evropiane gjithashtu ka njohur përmes rasteve të saj, që e drejta për një aktvendim të arsytuar nënkuptohet nga e drejta për gjykim të drejtë që garantohet nga KEDNJ neni 6.³³ Për më tepër, një aktvendim i arsytuar “i jep mundësi palës që të ankohet kundër saj, si dhe mundësi që vendimi të shqyrtohet nga një organ i apelit.”³⁴ Një vendim i arsytuar është i nevojshëm për “kontrollim publik të administrimit të drejtësisë:”³⁵ pa arsytet për arsytimin e vendimit pala ankuese nuk mund ta kundërshtojë si duhet aktvendimin e gjykatës më të ulët.

3. Urdhrat për mbrojtje janë lëshuar kundër anëtarëve të familjes që nuk janë të paditur

OSBE-ja ka vërejtur që nganjëherë gjykatat lëshojnë urdhra për mbrojtje që e kufizojnë sjelljen e jo vetëm të paditurve, por edhe të anëtarëve të familjes së të paditurit. Dhuna në familje në Kosovë shpesh përfshinë më tepër se dy palë. Mirëpo, urdhrat për mbrojtje dhe urdhra për mbrojtje emergjente janë efikas vetëm për sa i përket individëve që në mënyrë specifike emërohen si të paditur në kërkesë. Urdhrat për mbrojtje që caktojnë kufizime për individët tjerë nga i padituri në kërkesë shkojnë përtej fushëveprimit të së drejtës vendore, dhe përbëjnë shkelje të së drejtës së këtyre personave për gjykim të drejtë.³⁶ Urdhrat për mbrojtje asnjëherë nuk duhet të caktojnë kufizime në sjelljet e individëve që nuk janë emëruar si të paditurit e rastit.

Më 14 shkurt 2008, një kërkuese femër kishte parashtruar kërkesë pranë një gjykatë në Prishtinë për urdhër për mbrojtje emergjente kundër bashkëshortit të saj, duke thënë që ajo ka vuajtur nga presioni psikologjik dhe dhuna psikologjike e shkaktuar nga bashkëshorti dhe familja e tij. Ndonëse në të njëjtën kohë kryheshin

³¹ Citat nga neni i Rregullores së UNMIK-ut 2003/12 që thotë se LPC aplikohet për këto procedura.

³² Ligji për Procedurën Kontestimore, Ligji nr. 03/L-006, neni 182.2(n)

³³ Shih paragrafin 61 të Aktgjykimit të GJEDNJ *Van de Hurk kundër. Holandës*, e datës 19 prill 1994.,

³⁴ Shih paragrafi 34-38 të Aktgjykimit të GJEDNJ *Suominen kundër Finlandës*, të datës 24 korrik 2003.,

³⁵ *Po aty*.

³⁶ Shih nenin 2 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/12 për listën e masave që mund të merren me urdhrin për mbrojtje, urdhrin për mbrojtje emergjente apo urdhrin e përhoshëm emergjent. Nuk ka asgjë në këtë nen që parasheh që masat duhet të ndërmerren kundër personave tjerë që nuk janë të paditur. Mirëpo, urdhri për mbrojtje mund t'i mbrojtë personat tjerë që nuk janë kërkues (pra ndonjë person me të cilin pala e mbrojtur ka marrëdhënie familjare) (shih nenin 2.1 (p)).

edhe procedurat e shkurorëzimit pranë gjykatës, kërkuesja ka kërkuar urdhrin për mbrojtje sepse ajo frikohej për shëndetin dhe sigurinë e saj. Më 28 prill 2008, gjykata lëshojë një urdhër për mbrojtje që ndalonte të paditurin dhe familjen e tij nga kryerja e çfarëdolloj dhune në familje dhe t'ia lejojnë asaj përdorimin e pronës familjare. Më 24 mars 2009, i padituri paraqiti ankesë. Një nga bazat e ankesës ishte që anëtarët e familjes së të paditurit nuk ishin dëgjuar dhe që vendimi ishte marrë pa i shqyrtuar deklaratat e tyre. Më 4 korrik 2009, Gjykata e Qarkut nxori një aktgjykim për kthimin e rastit në gjykatën komunale për rishqyrtim. Mbi bazën e asaj që gjykata është dashur që t'i dëgjojë dëshmitarët për ta vërtetuar ekzistimin e dhunës në familje. Në seancën e rigjyimit të mbajtur më 24 korrik 2009 u dëgjuan, prindërit e ish-bashkëshortit të palës së mbrojtur në cilësinë e dëshmitarëve. Në po atë ditë, gjykata nxori një aktgjykim për vazhdimin e urdhrin për mbrojtje për një periudhë gjashtë mujore, duke filluar nga 25 shkurti 2009. Ndonëse kërkuesja asnjëherë nuk e kishte ndryshuar formalistë kërkesën e saj për të përfshirë në të anëtarë të familjes së të paditurit, zgjerimi i urdhrin mbrojtës është adresuar edhe kundër të paditurit dhe prindërve të ish-bashkëshortit të palës së mbrojtur.

Në një kërkesë të pranuar nga një gjykatë në rajonin e Prizrenit të datës 30 mars 2009, kërkuesja ka kërkuar urdhër për mbrojtje emergjente, duke thënë se ekziston dyshimi i bazuar se kanë ndodhur vepra penale të dhunës në familje. I vetmi i paditur i përmendur në kërkesë ishte partneri jashtëmartesor i kërkueses. Mirëpo, në padi ajo pohoi që dhuna kundër saj është kryer gjithashtu nga motra e të paditurit dhe anëtarët tjerë të familjes së të paditurit. Më 5 maj 2009, gjykata lëshoi një urdhër për mbrojtje, që ndalonte të paditurin dhe “anëtarët e tij të familjes” nga kryerja e çfarëdo akti të dhunës në familje kundër kërkueses apo të afërmeve të palës së mbrojtur.

Urdhri për mbrojtje që lëshohet nga gjykata i dorëzohet vetëm të paditurit.³⁷ Urdhrrat për mbrojtje të lëshuar kundër individëve të cilët nuk janë emëruar si të paditur në rast mund të kufizojnë sjelljen e këtyre individëve në mënyrë të paligjshme. Sjellja që nuk trajtohet si vepër penale si e tillë, siç është uzurpimi i një prone banimi, mund të bëhet vepër penale në rast se kryhet nga një anëtarë i familjes kundër së cilit është lëshuar një urdhër për mbrojtje. Prandaj, kur gjykatat lëshojnë urdhra për mbrojtje që kufizojnë sjelljen e individëve të cilët nuk janë emëruar si të paditurit e rastit, këta individ privohen nga e drejta e tyre për një proces të drejtë gjatë përcaktimit të obligimeve të tyre civile. Për më tepër, shkelja e urdhrin për mbrojtje në vete përbënë vepër penale.

D. Dështimi i herëpashershëm në ndjekje efektive të veprave të dhunës në familje

Në raportin e saj të mëparshëm për rastet e dhunës në familje, OSBE-ja, ndër të tjera, ka vënë re që prokurorët publikë në Kosovë nganjëherë dështojnë të bëjnë ndjekjen sipas detyrës zyrtare të veprave të dhunës në familje.³⁸ Vlen të përmendet që ky

³⁷ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12, Neni 8.4.

³⁸ Shih *Raportin e OSBE-së për rastet e dhunës në familje* (korrik 2007), faqe 17-19.

problem nuk është assesi i veçantë vetëm për Kosovën dhe së voni është identifikuar si një brengë e përgjithshme në nivel Evropian.³⁹

Që nga koha e raportimit të fundit, është vërejtur përparim në trajtimin e veprave të dhunës në familje, posaçërisht kur kemi të bëjmë me ndërveprimin dhe bashkëpunimin e akterëve institucional. Mirëpo, disa nga problemet e vërejtura më herët po vazhdojnë të ndodhin.

Në disa raste, autoritetet lëshojnë vetëm urdhra për mbrojtje në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2003/12, duke dështuar që të ndërmarrin edhe veprime administrative për ndjekjen e veprave të dukshme të dhunës në familje. Duhet të kihet para sysh që të gjitha autoritetet publike (përfshirë edhe gjyqtarët e lëmisë civile që lëshojnë urdhra për mbrojtje) kanë për detyrë që t'i referojnë rastet që përfshijnë sjellje të dukshme kriminale, te prokuroria publike për hetime të mëtutjeshme.⁴⁰ Lëshimi i urdhrat për mbrojtje nuk është zëvendësim i ndjekjes penale dhe incidentet që përfshijnë veprat e dhunës në familje duhet të hetohen dhe ndiqen në mënyrë efektive dhe energjike.

Kur të fillohen hetimet penale për veprat e dyshuara të dhunës në familje, prokurorët publik herë pas here shfaqin mungesë të gatishmërisë së duhur dhe nuk ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për një ndjekje efektive të të dyshuarit. Hetimet e pakompletuara, rrezikojnë rezultatin përfundimtar të rastit, edhe në rastet ku dëshmitë inkriminuese janë të mjaftueshme.

Në një rast pranë gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në janar të vitit 2009 një mashkull shqiptar ishte akuzuar për kryerje të veprës së përdhunimit,⁴¹ lëndimeve të rënda trupore,⁴² dhe kërcënimit⁴³ kundër partneres së tij me të cilën ai kishte jetuar në marrëdhënie jashtëmartesore për pothuajse 20 vite ku dhe kishin rritur së bashku një fëmijë të birësuar. I pandehuri siç ishte pohuar kishte keqtrajtuar rëndë partnerin e tij, si fizikisht ashtu edhe në mënyrë psikike; e kishte rrahur atë vazhdimisht me objekte të ndryshme të forta duke i shkaktuar lëndime të rënda; e kishte kërcënuar që do ta lëndonte dhe do ta vriste atë dhe anëtarët e familjes së saj; dhe e kishte përdhunuar atë. Kur viktimi e kishte raportuar rastin në polici, aty ishin bërë fotografime të lëndimeve të saj dhe pas një muaji një ekspert mjekësor dha një mendim lidhur me natyrën e lëndimeve të palës së dëmtuar në bazë të atyre fotografive. Kjo ishte katër muaj para se gjykata ta urdhëronte ekzaminimin mjekësor. Mirëpo, deri atëherë eksperti mjekësor ka mundur vetëm të konfirmojë që viktimi kishte pësuar lëndime të lehta trupore,⁴⁴ dhe nuk ka mundur që të mbështesë asnjë lëndim që do të dëshmonte përdhunimin apo lëndimin e

³⁹ Shih Raportin “Gjendja e të Drejtave të Njeriut në Evropë: Nevoja për të Çrrënjësuar Mosdëshkueshmërinë” lëshuar nga Komiteti për Çështje Ligjore dhe të Drejta të Njeriut pranë Këshillit të Evropës, I cili në paragrafin 53 thekson që dhuna kundër grave apo të ashtuquajturat “krime të nderit” shpesh nuk ndiqen me ashpërsinë e kërkuar për shkak të, ndër të tjera qëndrimeve arkaike kulturore që i vendosin vlerat si nderi i familjes apo detyra e fëmijëve për nënshtrim përmbi të drejtën e lirisë individuale apo edhe përmbi të drejtën për jetë.

⁴⁰ Në bazë të nenit 197 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, të shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/26, më 6 korrik 2003, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme (KPPK), “Të gjitha subjektet publike kanë për detyrë që të raportojnë veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare për të cilat ata janë informuar apo kanë mësuar në ndonjë mënyrë tjetër” dhe duhet “të ndërmarrin hapa për të ruajtur dëshmitë e veprës penale [...]”.

⁴¹ Neni 193, KPK.

⁴² Neni 154, KPK.

⁴³ Neni 161, KPK.

⁴⁴ Neni 153, KPK.

rëndë trupor. Më vonë prokurori e kishte ndryshuar akuzën nga lëndim i rëndë trupor në lëndim të lehtë trupor. Kur gjykata e nxori vendimin e saj në maj të vitit 2009 asaj iu deshtë që të mbështetej në masë të madhe në dëshminë e viktimës dhe në pranimin e pjesshëm nga i pandehuri. I pandehuri u gjet fajtor për përdhunim, lëndim të lehtë trupor dhe kërcënim, dhe u dënua me një dënim të përbashkët prej tetë vitesh e gjysmë heqje lirie.

Dështimi për të urdhëruar ekzaminimin e menjëhershëm mjekësor të viktimës së dhunës në familje në rastin e përmendur më lart paraqet një mungesë të tepruar të vullnetit nga ana e prokurorit për të ndërmarre hetimet. Një lëshim i tillë mund të shpie në humbjen e dëshmive shumë të rëndësishme dhe mund të rrezikojë të gjithë rrjedhën e procedurave penale. Prokurorët publikë në Kosovë duhet gjithnjë të hetojnë dhe ndjekin veprat e dhunës në familje në mënyrë efektive dhe energjike, ashtu siç kërkohet nga e drejta vendore⁴⁵ dhe ndërkombëtare.⁴⁶

Duhet të theksohet gjithashtu që incidentet e dhunës në familje që përfshijnë akte të dhunës serioze nuk janë vetëm çështje private, por edhe çështje brengosëse për publikun, që kërkojnë veprime nga autoritetet publike.⁴⁷ Si të tilla, autoritetet nuk duhet të mbështeten tepër në iniciativën e viktimës për bashkëpunim, por duhet t'i ndjekin krimet e tilla në mënyrë proaktive, të pavarur dhe efektive ashtu siç parashikohet nga ligji.

Rekomandime

Në frymë të asaj që u tha më lart:

- Gjyqtarët duhet të veprojnë në përputhje me ligjet relevante dhe gjatë marrjes së vendimeve lidhur me kërkesat për urdhër për mbrojtje të vendosin lidhur me kërkesat për urdhër për mbrojtje, si dhe për urdhër për mbrojtje emergjente brenda afateve të parapara ligjore,.
- Gjyqtarët duhet të sigurojnë praninë e përfaqësuesit të QPS-ve në rastet e dhunës në familje kurdo që njëra nga palët është i/e mitur.
- Gjyqtarët duhet t'i arsyetojnë vendimet e tyre si duhet në rastet e dhunës në familje përmes aktvendimeve të arsyetuara qartë të cilat i referohen fakteve të rastit dhe aplikimit të tyre në bazë të dispozitave relevante ligjore.
- Gjyqtarët duhet të sigurojnë që vendimet e tyre lidhur me kërkesat për urdhër për mbrojtje dhe urdhër për mbrojtje emergjente të jenë në përputhje me kërkesat e Rregullores së UNMIK-ut, duke e theksuar në mënyrë të qartë afatin kohor për urdhrin për mbrojtje, përgjegjësinë për shpenzimet e gjykatës në përputhje me ligjin dhe të drejtat dhe procedurat e ankimit.
- Të gjitha veprat e njohura të dhunës në familje duhet t'i referohen prokurorisë publike për hetime dhe, sipas nevojës, për ndjekje penale.
- Prokurorët publikë duhet të hetojnë dhe ndjekin rastet e dhunës në familje me kujdesin dhe përpikërinë e duhur; në veçanti, dëshmitë që mund të prishen duhet të mblidhen menjëherë pas incidentit dhe të futen në dosje të rastit si duhet.

⁴⁵ Neni 220(1) KPPPK.

⁴⁶ Shih në veçanti paragrafët 128-130 dhe 150 të Aktgjykimit të GJEDNJ-së *Opuz kundër Turqisë*, të datës 9 qershor 2009.

⁴⁷ Shih paragrafin 83 të Aktgjykimit të GJEDNJ-së *S. kundër Bullgarisë* të datës 12 qershor 2008 .

- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet të vazhdojë trajnimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë si dhe të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, lidhur me ligjin kundër dhunës në familje.